

**VENDIM**  
**Nr. 853, datë 26.12.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.538, DATË 26.5.2009, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO  
NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB) DHE DISA  
RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 36, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në aneksin 1, “Kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet QKB-së”, në fushën X, “Kujdesi shoqëror dhe punësimi”, për kategorinë X.2, “Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose formimit profesional”, kreu IV, pika 9.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9.1 Të gjitha subjektet, që disponojnë licencë për formim profesional, kanë detyrimin të aplikojnë për ndryshimet e nevojshme, në përputhje me kriteret e reja, me qëllim mbajtjen e licencës, brenda datës 30 gusht 2025, në të kundërt ajo do të revokohet.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**